



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 162/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.04.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim” Nr. REF-86736-02-11-2021 me objekt: “Blerje lubrifikante (vajra, graso, filtra, etj.) për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë”, me fond limit: 2 297 109 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 02.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

**Ankimues:** “Eximoil” SHA  
Rruga: Kashar, Yrshek, Qendër e Komunës, ‘Kashar’, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Divjakë  
Lagjja nr. 2, Divjakë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor,, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Nuk kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik .

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit, “Kërkesë për propozim” Nr. REF-86736-02-11-2021 me objekt: “Blerje lubrifikante (vajra, graso, filtra, etj) për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë”, me fond limit: 2 297 109 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 02.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

II.2. Në datën 02.03.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 02.03.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                   |                                     |
|-------------------|-------------------------------------|
| 1. “Kadiu” SHA    | 1.536.369 lekë pa TVSH, kualifikuar |
| 2. “Eximoil” SHA  | 1.835.010 lekë pa TVSH, kualifikuar |
| 3. “Top Oil” SHPK | 2.155.400 lekë pa TVSH, kualifikuar |

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konstatohet se në datë 10.03.2021 është publikuar “Njoftimi i fituesit”.

II.5. Në datën 17.03.2021 autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit.

II.6. Ankimuesi pretendon se ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në datën 19.03.2024. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1203/2prot. Datë 02.04.2021 rezulton se ankesa e ankimuesit është protokolluar pranë autoritetit kontraktor në datën 24.03.2021.

II.7. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pretendon se nuk ka marrë kthim përgjigjeje nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e tij. Ndërkohë që, referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së, është bashkëlidhur edhe dokumenti me nr.1128/2 prot, datë 25.03.2021, i objekt “Kthim përgjigjeje”, ku autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Eximoil” SHA, duke e rrëzuar atë.

II.8. Në datën 24.03.2021 ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë vijon:

*[...]Operatori “Eximoil” SHA ka prezantuar ofertën ekonomike pranë AK-së Bashkia Divjakë për procedurën me objekt “Blerje lubrifikante (vajra, graso, filtra, etj.) për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë” me fond limit: 2 297 109 lekë pa TVSH.*

*Autoriteti kontraktor ka publikuar raportin përmbledhës të vlerësimit të ofertave duke bërë klasifikimin e ofertave sipas çmimit më të ulët, sipas llojit të përzgjedhjes çmimi më i ulët .*

*Më datë 12.02.2021 AK-ja ka publikuar në sistemin e APP-së njoftimin për anulimin e vazhdimin të procedurës së prokurimit pas fazës së kualifikimit të ofertave me arsyetimin se operatori ekonomik i listuar i pari në raportin përmbledhës i shpallur fitues i procedurës ka hequr dorë nga nënshkrimi i kontratës.*

*Më datë 19.03.2021 Operatori Eximoil” SHA referuar legjislacionit të prokurimeve rregullave të prokurimit publik ka kryer ankimin për anulimin e paligjshëm të procedurës së prokurimit nga ana e AK-së Bashkia Divjakë.*

*Më datë 23.03.2021 në SPE AK-ja Bashkia Divjakë ka ripublikuar procedurën e prokurimit me objekt “Blerje lubrifikante (vajra, graso, filtra, etj.) për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë” të anuluar me nr. REF-90524-03-19-2021 në shkelje flagrante të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik pa vendim të ankimit të operatorit ekonomik “Eximoil” SHA pa pritur mbarimin e afateve të ankimit si dhe pa pritur vendimin përfundimtar nga ana e KPP-së.*

*Referojmë VKM-në RrPP Neni 78 të saj [...].*

*Me rikuperimin e procedurës së prokurimit në sistemin e APP-së vihet re AK Bashkia Divjakë nuk ka respektuar asnjë nga pikat e sipërpërmendura nuk ka pezulluar procedurën e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar por ka vazhduar me anulimin dhe ripublikimin e procedurës në sistem.*

*Sa i përket vendimit jo të ligjshëm të anulimit të procedurës me objekt “Blerje lubrifikante (vajra, graso, filtra, etj.) për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë” me nr. REF-86736-02-11-2021 ju bëjmë me dije se:*

*Më datë 02.11.2021 AK-ja Bashkia Divjakë ka publikuar në SPE të APP-së procedurën e prokurimit me objekt, Blerje lubrifikante (vajra, graso, filtra, etj.) për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë” sipas pikës 4.2 të DST kriteret e përzgjedhjes së fituesit çmimi më i ulët.*

*Më datë 12.02.2021 AK-ja ka publikuar njoftimin e vlerësimit të ofertave ku është bërë dhe renditja e OE-ve pjesëmarrës sipas ofertave përkatëse nga oferta më e ulët tek ajo më e larta.*

*Më datë 18.03.2021 AK-ja ka shpallur njoftimin e anulimit të procedurës me arsyetimin e mosrealizimit të procedurës nga ofertuesi e renditur i pari për shkak të pandemisë.*

*Referuar legjislacionit për prokurimin publik me tërheqjen nga realizimi i procedurës nga operatori ekonomik i renditur i pari për shkak të pandemisë.*

*Referuar legjislacionit për prokurimin publik me tërheqjen nga realizimi i procedurës nga operatori ekonomik i renditur i pari AK-ja është i detyruar të vazhdojë procedurën me operatorin e renditur i dyti në njoftimin e renditjes së ofertave.*

*Shkaqet e anulimit të procedurës nuk përfshihen në nenin 98 të ligjit për prokurimin publik.*

*Anulimi i një procedure prokurimi[...]*

*Neni 25/1 Njoftimi i anulimit[...]*

*Për këtë arsye njoftimi i anulimit është i paligjshëm dhe nëpërmjet këtij ankimi kërkohet prishjen e këtij vendimi dhe vazhdimin e procedurës duke shpallur fitues operatorin ekonomik të renditur i dyti shoqëria “Eximoil” SHA me ofertën 1.835.010 lekë sipas formularit të ofertës.*

*Operatori ekonomik “Eximoil” SHA ka bërë ankim mbi anulimin e procedurës së prokurimit të sipërpërmendur dhe ka dërguar ankimin nëpërmjet shërbimit postar.*

*Deri në këto momente nuk jemi njohur me asnjë vendim të AK Bashkia Divjakë, por jemi njohur me ripublikimin e procedurës së prokurimit në sistemin e APP-së [...]*

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr.1203/1 prot datë 02.04.2021 protokolluar me tonën me nr.465/2 datë 06.04.2021 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Në datën 12.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit, “Kërkesë për propozim” Nr. REF-86736-02-11-2021 me objekt: “Blerje lubrifikante (vajra, graso, filtra, etj.) për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë”, me fond limit: 2 297 109 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 02.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

III.1.1. Në datën 02.03.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.1.2. Në datën 02.03.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikim/skualifikimin e tyre.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konstatohet se në datë 10.03.2021 është publikuar “Njoftimi i fituesit”.

III.1.4. Në datën 17.03.2021 autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit.

III.1.5. Ankimuesi pretendon se ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në datën 19.03.2024. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1203/2 prot. Datë 02.04.2021 rezulton se ankesa e ankimuesit është protokolluar pranë autoritetit kontraktor në datën 24.03.2021.

III.1.6. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pretendon se nuk ka marrë kthim përgjigjeje nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e tij. Ndërkohë, që referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së, është bashkëlidhur edhe dokumenti me nr.1128/2 prot, datë 25.03.2021, e objekt “Kthim përgjigjeje”, ku autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Eximoil” SHA, duke e rrëzuar atë.

III.1.7. Në datën 24.03.2021 ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

*“1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*

*1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.*

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”.

III.1.9. Në rastin konkret, nga verifikimet e kryera rezulton se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në datën 24.03.2021 brenda afateve ligjore të ankimit parashikuar nga neni 63 pika 2 e LPP-së. Ndërkohë Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ka dorëzuar ankesë pranë K.P.P. më datë 24.03.2021, brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 e LPP-së për kthimin e përgjigjes nga ana e autoritetit kontraktor dhe para afatit të parashikuar në pikën 6 të nenit 63 të LPP-së për nisjen e afatit të ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar shkallët e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, ç’ka rrjedhimisht sjell si pasojë, që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në K.P.P., duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që referuar nenit 20, pikës 2, shkronja “e”, të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

Sa më sipër, K.P.P. gjykon se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 24.03.2021 është dorëzuar përpara mbarimit të afatit të autoritetit kontraktor për të trajtuar ankesën pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor dhe përfundon ditën e dhjetë.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve të ankimit, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

III.1.10. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk mund të konsiderohet si

ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ, pasi për faj të vetë ankimuesit, ankimimi në autoritetin kontraktor dhe KPP nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eximoil” SHA, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim” Nr. REF-86736-02-11-2021 me objekt: “Blerje lubrifikante (vajra, graso, filtra, etj.) për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë”, me fond limit: 2 297 109 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 02.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 465 Protokoli, Datë 24.03.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**